



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 210, datë 08.10.2024

PËR

**“MIRATIMIN E RENDITJES DHE CAKTIMIN E ZONJËS ERMIRA
MANELLI NË DETYRËN E PROKURORIT NË PROKURORINË PRANË
GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË
PËRGJITHSHËM ELBASAN, NËPËRMJET PROCEDURËS SË LËVIZJES
PARALELE”**

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 41 dhe 43 të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 164, pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a” të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, nenin 44 dhe 45 të Rregullores “Mbi transferimin e prokurorëve nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele” e ndryshuar, si dhe në relacionin shpjegues të paraqitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e renditjes së kandidatëve të cilët kanë konkuruar për transferim nëpërmjet lëvizjes paralele, për pozicionin vakant shpallur me vendimin nr. 92, datë 09.05.2023 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, si më poshtë:
 - a. Ermira Manelli
2. Caktimin e zonjës Ermira Manelli në detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, në pozicionin vakant shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë Nr.92, datë 09.05.2023.
3. Të ndërpritet caktimi i përkohshëm i prokurores Ermira Manelli, miratuar me vendimin nr. 114, datë 09.07.2024.
4. Relacioni i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.
5. Të njoftohen për këtë vendim prokurorja Ermira Manelli, Prokurori i Përgjithshëm, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.

U shpall në Tiranë, sot më 08.10.2024.



KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETAR
Mirela Bogdani

ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Zeqir Hoda

ANËTAR
Arta Mandro

ANËTAR
Ledina Riza

ANËTAR
Moisi Duda

ANËTAR
Olger Eminaj

ANËTAR
Erind Gërmenji

ANËTAR
Erind Merkuri